



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORE
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 2631 prot.

Vlorë, më 17.02 2025

INFORMACION MBI RAPORTIN VJETOR TË VEPRIMTARISË DHE
VENDIMMARJEN E KËSHILLIT TË BASHKISË PËR PERIUdhËN
1 JANAR- 31 DHJETOR 2024

Të nderuar Këshilltarë!

1. Të Përgjithshme

Ky informacioni ose raport i performancës për punën, aktivitetet dhe vendimmarjen e Këshillit të Bashkisë gjatë vitit kalendarik 2024, sikurse jeni në dijeni, është një detyrim i parashikuar në Rregulloren “Për Organizimin dhe Funksionim e Këshillit të Bashkisë Vlorë” neni 111 pika 3.

Ky informacion është i rëndësishme të njihet nga Këshilli i Bashkisë por vecanërisht në kuadër të parimit të transparencës së Këshillit të Bashkisë në marrëdhëniet me qytetarët si dhe me median. Njëkohësisht shërben edhe si një raport ose llogaridhënie e Këshillit të Bashkisë lidhur me mënyrën e ushtrimit të funksioneve të tij si organ përfaqësues e vendimmarës referuar parashikimeve në Ligjin nr.139/2015 dt 15.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar.

Para se të japim një pasqyrë të detajuar të punës, aktiviteteve dhe vendimmarjes së Këshillit të Bashkisë për vitin 2024, e rëndësishme për të theksuar është fakti që çdo vendimmarje e Këshillit të Bashkisë Vlorë ka synuar të ketë një impakt pozitiv në komunitetet që përfaqësohen, pa bërë përjashtime ose dallime dhe pa u ndikuar nga përkatësia etnike, politike etj, si dhe pa u ndikuar nga përkatësia politike e këshilltarëve pavarësisht debatit politik të zhvilluar për vendime të ndryshme. Në funksion të këtij qëllimi referuar parashikimeve në dispozitat ligjore në fuqi çdo vendimmarje i është nënshtruar konsultimit publik kur ka qënë e detyrueshme dhe janë vlerësuar opinionet e komunitetit dhe kërkesat e publikut.

Është për tu vlerësuar gjithashtu edhe fakti që në të gjitha rastet e vendimmarjes së Këshillit të Bashkisë bashkëpunimi ndërmjet Kryetarit të Bashkisë si organ ekzekutiv dhe Këshillit si organ përfaqësues nuk ka munguar për të realizuar zgjidhje sa më efektive të problematikave

të shtruar për zgjidhje gjatë vitit 2024. Kjo ka bërë që të mos ketë asnjë rast të kundërshtimit të vendimeve të miratuara nga Këshilli i Bashkisë prej Kryetarit të Bashkisë.

Gjatë kësaj periudhe një vjeçare ka patur vetëm 1(një) rast ku projektvendimi i paraqitur nga Administrata e Bashkisë për miratim është kthyer Administratës për plotësim të mangësive të konstatuara si dhe ka pasur 2(dy) raste që projektvendimet e paraqitura nga Administrata e Bashkisë nuk janë miratuar në mbledhjen e radhës për mungesë së kourumit të domosdoshëm por që janë miratuar në mbledhjen pasardhëse pa ndryshime, konkretisht projektvendimet për krijimin e ndërmarrjes së pastrimit si dhe projektvendimi për miratimin e numrit të punonjësve të Bashkisë.

2. Funksionimi dhe Vendimmarrja e Këshillit.

2.1 Mbledhjet

Referuar aktiviteteve të zhvilluara dhe vendimeve të miratuara nga Këshilli i Bashkisë gjatë vitit 2024 rezulton se:

- 1) Gjatë vitin 2024 janë zhvilluar 15(pësëmbëdhjetë) mbledhje të Këshillit të Bashkisë nga të cilat:
 - a. 12(dymbëdhjetë) mbledhje mujore sipas parashikimit në Rregullores “Për Organizimin dhe Funksionimin e Këshillit të Bashkisë Vlorë” si dhe në planin vjetor të aktiveve të Këshillit të Bashkisë për vitin 2024, sipas të cilave Këshilli i Bashkisë mbledhet minimalisht 1(një) herë në muaj.
 - b. 3(tre) mbledhje janë jashtë rradhe për të cilat ka patur kërkesë për çështje të ndryshme nga Kryetari i Bashkisë ose grupe Këshilltarësh.

2.2 Vendimet

Gjatë vitit 2024 Këshilli i Bashkisë ka miratuar 113 vendime, objekti i të cilave ka qënë si më poshtë:

1) Ndihma ekonomike	28 vendime
2) Emergjencat Civile	14 vendime
3) Buxheti dhe ndryshime të tij	18 vendime
4) Shërbime dhe strehimi	14 vendime
5) Emërtime rruge dhe tituj nderi	8 vendime
6) Taksat dhe Tarifatat Vendore	3 vendime
7) Vendime të tjera	28 vendime*

**Projektvendime për miratimin e disa rregulloreve, për pagat, miratimin e numrin e punonjësve të Bashkisë dhe Institucioneve të varësisë, marrëveshje bashkëpunimi me institucioneve të tjera etj.*

Këshilli i Bashkisë bazuar në dispozitat ligjore në fuqi për problematika të ndryshme para çdo vendimmarje për të cilat është i detyrueshëm konsultimi publik ka organizuar së bashku me Administratën e Bashkisë dëgjesa publike me grupe interesi si dhe publikun e gjerë. Gjatë vitin 2024 janë zhvilluar gjithësej 18 dëgjesa publike ku kanë marrë pjesë anëtarë të komunitetit të interesuar, përfaqësues të OJF-ve që kanë aktivitet në qytetin e Vlorës, Këshilltarë etj. Duhet theksuar specifikisht se janë organizuar 9 dëgjesa për Buxhetin e Bashkisë për vitin 2025 si dhe atë afatmesëm 2025-2027 në të gjitha ndarjet Administrative të Bashkisë Vlorë, 5 Rajone dhe 4 Njësi Administrative.

Është për tu theksuar fakti se vendimet për ndihmën ekonomike, për emergjencat civile, si dhe titujt e nderit etj nga Këshilli i Bashkisë, pavarësisht përfaqësimit politik të këshilltarëve janë miratuar unanimisht nga të gjithë këshilltarët prezent në mbledhjen përkatëse të Këshillit. Parë në këtë këndvështrim është për tu vlerësuar angazhimi i pothuajse tërësisë së Këshilltarëve për të ndihmuar banorët e prekur nga përmytjet e 04.10.2024 si dhe angazhimi i tyre në vendimmarje për suport financiar për ta. Ndërkohë vendimet për çështje të Buxhetit, të projekteve në shqyrtim, për Taksat dhe Tarifatat Vendore janë debatuar në mbledhjet e komisioneve ose ato të Këshillit dhe janë miratuar nga shumica e këshilltarëve sikurse parashikohet në Ligj.

Të gjitha vendimet e miratuara nga Këshilli i Bashkisë bazuar në Ligjin Nr. 139/2015 dt. 17.12.2015 "Për Vetëqeverisje Vendore" i ndryshuar si dhe në Ligjin nr. 107/2016 dt. 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut" i ndryshuar janë depozituar pranë Prefektit të Qarkut për marrje të ligjshmërisë dhe për të gjitha vendimet nga ana e tij është konstatuar se kanë qënë në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

2.3 Komisionet

Një rol të rëndësishëm për vendimmarjen e Këshillit kanë luajtur edhe zhvillimi, para mbledhjes së Këshillit, i mbledhjeve të Komisioneve të përherëshme. Kjo pasi në mbledhjet e Komisioneve janë diskutuar propozimet dhe problematikat e paqarta të projektvendimeve të paraqitura, problematika të cilat në bashkëpunim me Administratën e Bashkisë janë adresuar përpara vendimmarjes së Këshillit.

Gjatë vitit 2024 janë zhvilluar 40(dyzet) mbledhje të Komisioneve të Përherëshme të Këshillit.

Pavarësisht Rendit të Ditës të mbledhjeve të Këshillit, Komisioni juridik, i rendit dhe sigurisë publike dhe ai për çështjet ekonomike, financiare dhe privatizimet si rregull në tërësi janë mbledhur para çdo mbledhjeje të Këshillit. Ndërkohë komisionet e tjera janë mbledhur sipas rastit në funksion të fushave që mbulojnë sipas objektit të projektvendimeve të cilat kanë qënë për tu shqyrtuar në mbledhjet përkatëse.

Konkretisht mbledhjet e komisioneve të këshillit bashkiak për vitin 2024 janë zhvilluar si më poshtë:

Nr.	Emërtimi i Komisionit	Mbledhje të zhvilluara
1.	Komisioni Juridik i Rendit dhe i Sigurisë Vendore Publike.	13
2.	Komisioni i për Çështjet e Ekonomisë, Financave dhe Privatizimit.	10
3.	Komisioni i Shërbimeve Publike, Transportit, Infrastrukturës dhe Strehimit.	5
4.	Komisioni për zhvillimin Urbanistik dhe Ndertimet.	2
5.	Komisioni për Arsimin, Kulturën dhe Sportet.	2
6.	Komisioni i Shendetësisë, Veterinarisë, Mjedisit dhe zhvillimin e turizmit.	2
7.	Komisioni i Bujqësisë, Pyjeve dhe Menaxhimit të ujërave	2
8.	Komisioni i Barazisë Gjinore dhe përfshirjen Sociale	2
9.	Komisioni i Mandateve dhe Rregullores	1
10.	Komisioni i Marrëdhënieve me Jashtë dhe Integrimin Europian	1
Totale		40

Pavarësisht sa më lartë në varësi të Rendit të Ditës gjatë vitit 2024 është kërkuar zhvillimi i mbledhjeve të komisioneve në 56(pesëdhjetë e gjashtë) raste por që për mosplotësim të kourumit në 16(gjashtëmbëdhjetë) raste nuk janë zhvilluar. Kjo kërkon një angazhim më të mirë të këshilltarëve anëtarë të komisioneve përkatëse me qëllim që diskutimet e planifikuara ose të kërkuara të komisioneve të mos dështojnë për mosplotësim të kourumit të domosdoshëm.

Sikurësë theksuam më lartë, në 2(dy) raste Projektvendimet e paraqitura për miratim në Këshillin e Bashkisë nuk janë miratuar në mbledhjen e radhës për mosplotësim të kourumit të domosdoshëm. Kjo ka ndodhur pasi për arsye të ndryshme disa këshilltarë nuk kanë marrë pjesë në këto mbledhje të Këshillit. Është detyrë e secilit që si në mbledhjet e Komisioneve të përherëshme edhe në mbledhjet e Këshillit të jenë pjesëmarrës pasi janë të mandatuar si përfaqësues i komunitet pavarësisht përfaqësimit politik.

Konkretisht konstatohet se disa këshilltarë kanë më shumë mungesa si në mbledhjet e Këshillit dhe ato të Komisioneve ku janë aktualisht anëtarë, sigurisht pa tejkaluar limitin e parashikuar në Rregullore. Nga 51(pesëdhjetë e një) anëtarë të Këshillit të Bashkisë, vetëm 7 këshilltarë nuk kanë munguar në asnjë mbledhje të Këshillit. 20(njëzetë) këshilltarë kanë bërë deri në 2(dy) mungesa, ndërkohë që disa këshilltarë kanë munguar në 5-6(pesë deri në gjashtë) mbledhje rradhazi por që sikurse cituam më lartë, nuk i kanë realizuar ato për 6(gjashtë) muaj rradhaz, gjë që do të vintë në diskutim mandatin e tyre si këshilltar.

3. Transparenca dhe Bashkëpunimi me Institucionet e tjera

Në kuadër të programit të transparencës çdo aktivitet dhe vendimarrje të Këshillit të Bashkisë Vlorë transmetohet në Facebook Live si dhe në mediat lokale në kohë reale. Nga sondazhet konstatohet se mbledhjet e Këshillit të Bashkisë ndiqen mesatarisht nga 5500 persona, numër që ka tendencë rritjeje. Këto transmetime më pas mbeten në rrjetet sociale dhe janë të aksesueshme për të gjithë publikun në çdo moment.

Gjithashtu projektvendimet, Vendimet, procesverbalet e mbledhjeve si dhe njoftimet për mbledhjen e Këshillit publikohen në faqen e Bashkisë www.vlora.gov.al si dhe në faqen www.vendime.al/vlore.

Po ashtu në mediat sociale dhe në faqen e Bashkisë publikohen dhe lajmërimet për dëgjuesat publike, rregulloret e Këshillit, planin e aktiviteteve si dhe informacione të tjera të përgjithëshme mbi përbërjen dhe funksionimin e Këshillit të Bashkisë.

Në kuadër të transparencës në formën e llogaridhënies në muajin tetor 2024 në bashkëpunim me projektin “Bashki të Forta” u organizua një sesion informues i Këshillit të Bashkisë Vlorë ku u prezantua aktiviteti dhe puna e Këshillit Bashkiak përpara qytetarëve të Vlorës dhe përfaqësues se OJF-ve. Në këtë aktivitet morrën pjesë rreth 60 persona, kryesisht përfaqësues të OJF-ve por edhe të interesuar nga komuniteti i gjerë. Gjithashtu në aktivitet e tjera që janë zhvilluar nga projekti “**Bashki të Forta**” sipas tematikave të diskutuara kanë marrë pjesë anëtar të Këshillit të Bashkisë, përfaqësues të Komisioneve përkatëse.

Rëndësi i është kushtuar edhe bashkëpunimit dhe shkëmbimit të eksperiencave me Këshilla të Bashkive të qyteteve të tjera. Konkretisht janë zhvilluar takime me Këshillin e Bashkisë Sarandë, Këshillin e Bashkisë Maliq dhe Këshillin e Bashkisë Shijak.

Gjithashtu Anëtarë të Këshillit, Sekretari dhe Kryesia e Këshillit kanë marrë pjesë në takimet e dt 01.03.2024 lidhur me gjetjet e raporteve të përgatitura nga Qendra Rinore Vlorë si dhe programi Fakte.al për bashkëpunimin e Këshillit me grupet e interesit në funksion të vendimarrjes. Ndërkohë në takimin e dt 01.12.2024 janë diskutuar gjetjet e studimit, transparenca dhe përgjegjësi në nivel vendor, vlerësimi i proceseve të konsultimit publik në Vlorë ku sigurisht ka konstatime se konsultimit publik duhet ti kushtotet rëndësi e veçantë nga Këshilli i Bashkisë në tërësi dhe çdo këshilltarë në veçanti por edhe nga pjesëmarrja më e shtuar e publikut.

Një rëndësi e veçantë i është kushtuar edhe kërkesave dhe ankesave që i adresohen Këshillit nga Komuniteti ose Institucione të tjera, protokoli i të cilave gjendet gjithashtu edhe në faqen online të Bashkisë Vlorë. Konkretisht gjatë vitit 2024 në adresë të Këshilli të Bashkisë janë depozituar 80 shkresa për çështje të ndryshme nga të cilat 40 kërkesa dhe ankesa nga qytetarët, 7 kërkesa nga Institucione jashtë Bashkisë dhe 33 shkresa në të cilat janë përcjellë Administratës së Bashkisë pyetjet, kërkesat dhe ankesat të Anëtarëve të Këshillit të Bashkisë.

Për sa i përket kësaj korespondece, Sekretariati i Këshillit ka qënë në komunikim të vazhdueshëm me Administratën e Bashkisë për të adresuar problematikat e shtruara për zgjidhjen në të gjitha rastet.

4. Shpenzimet e Këshillit

Për sa i përket shpenzimeve të planifikuara në Buxhetin e Bashkisë në vitin 2024, në funksion të punës dhe aktiviteteve të Këshillit të Bashkisë, rezulton se në tërësi janë realizuar ato për kancelari dhe pajisje zyre. Kërkesat e parashikuara për funksionimin normal të sallës së mbledhjes së Këshillit për arsye të ndryshme nuk u realizuan. Duke qënë se procedurat përkatëse për ato shpenzime realizohen nga Administrata e Bashkisë, është detyrimi i saj të realizojë sa më shpejtë të jetë e mundur referuar edhe shqetësimit të vazhdueshëm të anëtarëve të Këshillit, Kryetarëve të Grupeve të Këshilltarëve si dhe Kryesisë së Këshillit.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin!

KRYETAR
Elpinqi Mërkuri

